

VENDIM
Nr. 720, datë 28.8.2013

**PËR LEJIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR,
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Shërbimit Informativ të Shtetit, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, për objektet e mëposhtme:

- a) “Blerje pajisjesh të teknologjisë së informacionit (kompjuter, skaner, printer, server, laptop i kriptuar”;
- b) “Shpim pusi uji teknologjik dhe instalime hidraulike”;
- c) “Blerje dhe montim pompe për distributorin e karburantit”;
- d) “Blerje pjesësh këmbimi dhe filtrash për automjete”.

2. Ngarkohen Shërbimi Informativ i Shtetit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha